

**KREU I**

**EMRI DHE FORMA E SHOQĒRISĒ, SELIA, KOHĒZGJATJA, OBJEKTI**

**NENI 1**

**DATA, EMRI DHE FORMA E SHOQĒRISĒ**

- 1.1 Sot me date **16.06.2023** eshte themeluar shoqeria me përgjegjësi të kufizuar me emrin **FUTURA 23 CONSTRUCTION** (më poshtë e quajtur "Shoqeria").
- 1.2 Shoqeria është e organizuar në formën e një shoqerie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 1.3 Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjtë emërtim me kusht që personi juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

**NENI 2**

**SELIA**

- 2.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Adresa. Tirane ,Sauk nr ap 4 ,zona kadastrale nr3266 nr pasurie 176/55/nd+1-4 1001.
- 2.2 Ortaku i Vetëm mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose myllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

**NENI 3**

**KOHĒZGJATJA**

3.1 Shoqeria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 4**

**OBJEKTI I SHOQĒRISË**

- 4.1 Projektimi dhe zbatimi i veprave ndertimore.Ndertime me karakter civil dhe ekonomik,punime/germime dhe istemime dheu,tarracime terrenesh,rikonstruksione godinash,veshje fasadash,ndertime urash,rrugesh,kuz e kub dhe konstruksione metalike,montime panelesh,si dhe cdo ndertim tjeter me karakter civil dhe ekonomik.Tregetim me shumice dhe pakice materiale ndertimi.materiale elektrike,hidraulike dhe hidrosanitare.Studime fizibiliteti Studim,projektim,mbikqyrje, kolaudim per ndertim e zbatim te veprave ndertimore te te gjitha llojeve sipas legjislacionit



shqiptar. Studime urbanistike te te gjitha niveleve; planifikim urban; projektim arkitektonik; projektim strukturash mbajtse beton-arme, metalike, projektim rrugesh, autostradash, aeroportesh, heliportesh, vleresime mjedisore; projektim linjash dhe sistemesh te prodhimit dhe shperndarjes se energjise elektrike; projektim ujesjelles kanalizime, vepra ujitje, kullimi, impiante vaditese, diga, dampa, etj; projektim vepra naftesjelles, gazsjelles, etj; projektim fotogrametrik, hartografik, topografik; konsulenca tekniko-ekonomike sipa kategorive dhe nenkategorive te licensave profesionale dhe cdo lloj studimi dhe projektimi, qe nuk perrnendet me siper. Blerje e tjetersime te pasurive te luajtshme e te paluajtshme. Te bleje ne menyre te drejtperdrejte apo te terthorte interesa ne shoqeri te tjera me objekt te ngashhem me ate te Shoqerise, ne Shqiperi apo jashte saj, dhe te kryeje cdo aktivitet tjeter qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem per arritjen e objektit te Shoqerise. Shoqeria duhet te kryeje cdo aktivitet qe perfshihet ne objektin e saj ne lidhje dhe qe e favorizon ate. Shoqeria duhet te respekoje te gjitha ligjet dhe rregulloret perkatese. Ajo perfshin standartet me te mira etike. Objekti i shoqerise mund te zgjerohet ose ndryshoje me vendim te Ortakut.

**KREU II  
KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI**

**NENI 5  
KAPITALI I SHOQËRISË**

**5.1** Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 2 000 000 Lekë, i ndarë në 1 ( një ) pjesë ku vlera nominale e një pjese është 2 000 000 Lekë. Kuota e zoterimit te kapitalit te shoqerise 100% derdhur nga ortaku i vetem themelues Z. ERMAL FANI, i biri VLADIMIR, lindur ne **BERAT** me date **04.02.1983** me numer **ID H86007026J** dhe banues ne **Rr .Eduard Mano** nd.21 ,H 2 ,Farke Selite 1044 Tirane , Shqipëri, person madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar.

**NENI 6  
TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TEK TË TRETET**

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Ortaku i Vetëm, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një noteri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

**NENI 7  
BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT**



- 7.1** Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.

**KREU III  
NDRYSHIMI I KAPITALIT**

**NENI 8**

- 8.1** Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributeve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Ortakut të Vetëm mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Ortakut të Vetëm apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2** Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**NENI 9  
ZMADHIMI I KAPITALIT**

- 9.1** Ortaku i Vetëm, mund të vendosë që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/viteve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Ortaku i Vetëm, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitet e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2** Pas marrjes së një vendimi të tillë, Ortaku i Vetëm cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3** Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, ortaku i vetëm i shoqërisë, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.
- 9.4** Pas marrjes së vendimit të dytë nga Ortaku i Vetëm, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij neni do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

**KREU IV  
ORGANIZIMI I SHOQËRISË  
NENI 10**

Tani

## STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

- 10.1** Shoqëria tregtare **FUTURA 23 CONSTRUCTION** ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse: Ortaku i Vetëm si organi vendimmarrës për shoqërinë ; Administratorin

### NENI 11

#### **DETÝRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS**

- 11.1** Ortaku i Vetëm, si organ vendimmarrës për shoqërinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesës;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 11.2** Ortaku i Vetëm merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ç" të pikës "l" të këtij nenit, pas marjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
- 11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm do të regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrimit dhe mbajtja e vendimeve përcaktuara me vendim të ortakut të vetëm. Ortaku i vetëm, me vendim, mund të ngarkojë dhe një person fizik për mirëmbajtjen e regjistrimit të mbledhjeve.
- 11.4** Nga ana e Ortakut të Vetëm merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organeve përkatëse shtetërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
  - c) investime;
  - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - d) vendimet e marra në zbatim të nenit 9 të këtij statutit.
- 11.5** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

**NENI 12  
MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMMARRËS**

- 12.1** Mbledhja e Ortakut të Vetëm zhvillohet në rastet e përaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.
- 12.2** Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nga kryesisht nga ortaku i vetëm, administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nevojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3** Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4** Mbledhja e Ortakut të Vetëm thirret nga personat e tjera të parashikuar nga pikë 12.2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së parashikuar në mbledhjen e Ortakut të Vetëm. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktiveve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

**KREU V  
ORTAKU I VETËM, FINANCIMET**

**NENI 13  
ORTAKU I VETËM**



- 13.1 Ortak i Vetëm i Shoqërisë është Z. ERMAL FANI, i biri VLADIMIR, lindur ne BERAT me date **04.02.1983** me numer **ID H86007026J** dhe banues **Rr .Eduard Mano;** nd.21 ;H.2;Farke;Selite;1044;Tirane , Shqipëri

**NENI 14**  
**VENDIMET E ORTAKUT TË VETËM**

- 14.1 Ortaku i Vetëm, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me:  
(i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë,  
(iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratoreve  
si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e  
bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjetër financiar, (vi) shndërrimin,  
shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo  
vendim tjetër që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.
- 14.2 Vendimet e Ortakut të Vetëm duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në  
regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

**NENI 15**  
**TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT TË VETËM**

- 15.1 Të drejtat dhe detyrat e ortakut të vetëm janë:

- Të marrë pjesë në mbledhjet e Ortakut të Vetëm;
- Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e  
shoqërisë;
- Të informohet mbi përbajtjen e raportit te administrimit, inventarët e llogaritë  
vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspertit kontabël;
- Të përfitoje nga fitimi i shoqërisë;
- Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

**NENI 16**  
**FINANCIMI I SHOQËRISË**

- 16.1 Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç  
rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortaku i vetëm i shoqërisë  
fondet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2 Financimet e mëtejshme të ortakut në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo  
pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

**KREU VI**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 17**  
**ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 17.1** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga ortaku i vetëm për një periudhë pesëvjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:

**Z. ERMAL FANI**, i biri **VLADIMIR**, lindur ne **BERAT** me date **03.05.1982** me numer **ID H86007026J** dhe banues ne **Rr .Eduard Mano;nd.21 :H.2;Farke;Selite;1044;Tirane , Shqipëri.**

- 17.2** Në zbatim të këtij neni, administratori i vetëm përsaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetit tatileve dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës për veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjislacionit shqiptar.
- 17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nevojshme përritjen e objektit të Shoqërisë, përvèç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organeve të tjera të Shoqërisë.

**NENI 18**  
**TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT**

- 18.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:
- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - përsaqësojë shoqërinë tregtare;
  - kujdeset përmbiqen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet përmes shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përpëra Ortakut të Vetëm përmiratim;
  - krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";

- e) raportojë përpara Ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretë;
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

**NENI 19  
PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT**

- 19.1** Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

**NENI 20  
SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT**

- 20.1** Ortaku i Vetëm përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

**KREU VII  
KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË  
VITI FINANCIAR DHE BILANCI**

**NENI 21  
KONTROLLI KONTABËL**

- 21.1** Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspertë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjisacionin shqiptar në fuqi. Ortaku i Vetëm do të emërojë një apo më shumë ekspertë kontabël në ato raste kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërkohet në bazë të ligjit.
- 21.2** Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zevendësueshmërinë, tērheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjisacioni shqiptar në fuqi.

**NENI 22  
VITI FINANCIAR**

- 22.1** Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

**NENI 23  
BILANCI DHE REZERVAT**



- 23.1 Me mbylljen e secilit vit finansiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin finansiar të mbyllur, në mënyrë që Ortaku i Vetëm të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 23.2 Ortaku i Vetëm vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të viteve të mëparshme.
- 23.3 Ortaku i Vetëm në çdo moment mund të vendosë krijimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**NENI 24  
PUNËSIMI NË SHOQËRI**

- 24.1 Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përeaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të se cilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

**KREU VIII  
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 25  
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

- 25.1 Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjera që nuk varen nga Ortaku i Vetëm.
- 25.2 Shoqëria hyn në fazën e likuidimit qysh në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Ortaku i Vetëm emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivitit dhe pasivit te Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve te likuidimit dhe asatin e nevojshëm te përfundimit te tyre. Shoqëria prishet ne këto raste:
- Kur nuk mund të përbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
  - Me vullnetin e ortakëve;
  - Me vendim të Gjykatës
  - Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

**NENI 26**

**PROCEDURAT QË NDIQEN**

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare **FUTURA 23 CONSTRUCTION** vendoset nga Ortaku i Vetëm kur prishet shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar ne Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 26.3** Në qoftë se Ortaku i Vetëm, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkесën e likuiduesit ose çdo personi të interesuar.
- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Ortakut të Vetëm zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mireqenë.
- 26.5** Në fund të procesit të likuidimit thirret Ortaku i Vetëm për të vendosur në lidhje me bilancin finanziar përfundimtar.

**NENI 27  
NJOFTIMET**

- 27.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen personave ose që bëjnë personat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.
- 27.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjeteve elektronike vërtetohen sipas Legjisacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një person, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruarëve të kuotës.

**KREU IX  
BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË****NENI 28**

**28.1** Shoqëria **FUTURA 23 CONSTRUCTION** me anë të bashkimit mund ti kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron te njëtin aktivitet.

**28.2** Gjithashtu shoqëria **FUTURA 23 CONSTRUCTION** me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërise të reja.

**28.3** Në rast se operacioni përfshin krijimin e shoqërise të reja secila prej tyre themelohet sipas irregullave që i përkasin shoqërisë që do të krijohet.

**28.4** Transferimi i plotë i aktivit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Ortaku i Vetëm.

**KREU X  
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

**NENI 29  
LIGJI I ZBATUESHËM**

**29.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar ne këtë akt, do të zbatohen dispozitat e legislacionit shqiptar në fushën e shoqërise tregtare.

**NENI 30**

**30.1** Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

**ORTAKU I VETËM  
I  
SHOQËRISË FUTURA 23 CONSTRUCTION  
Z. ERMAL FANI**

*Ermal Fani Efanë*